REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Maliq, më 12.06.2026

Projekt-Vendim -NR. 5

PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TE VARRIMIT.

Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar , të nenit 8 pika 2 , nenit 9 nënpika 1.1, gërma "b",ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit 9220 datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit", i ndryshuar me ligjin nr. 80/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin ligjit 9220 datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit", neni 6/b pika 2, si dhe ligjit nr.121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", neni 36 roli i bashkisë pika 1,2,3, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Maliq:

I. Të miratojë kriteret mbi mbulimin e shpenzimeve të varrimit

1. Shpenzimet e shërbimit të varrimit kryhen nga njësia bazë e qeverisjes vendore ku individi është i regjistruar.
2. Përfitues të këtij shërbimi janë personat që jetojnë në kushtet e varfërisë, të braktisjes, të mungesës së interesit mes anëtarëve të familjes, ose për të cilët është e pamundur të identifikohen familjarë që bartin detyrimin, sipas pikës 1, të nenit 6 të ligjit 9220 datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit", i ndryshuar me ligjin nr. 80/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin ligjit 9220 datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit".
3. Administratori i Njësisë përkatëse dhe punonjësi social sigurojnë dokumentacionmin e nevojshëm për këtë shërbim si, akt vdekje, certefikate vdekje, lejë varrimi dhe relacion shpjegues mbi arsyet e përfitimit të këtij shërbimi.
4. Deklarimi i vdekjes bëhet nga personat më të afërt tëfamiljes dhe, në mungesë të tyre ose për personat pa njeri, nga Administratori i Njësisë Administrative ku I ndjeri ka gjendjen civile.
5. Procedura do te realizohet rast pas rasti sipas legjislacionit te prokurimit public me kerkese nga sherbimi social .

II. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor.

Konceptoi: Dr. Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Shëndetësisë E.Petriti

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026